



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

KPPP.nr. 419/22

GJYKATA KOMERCIALE, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtarja Verona Dibra, në çështjen përmbartimore të kreditorit Qeveria e Republikës së Kosovës - Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale – Trupi Ekzekutiv i Inspektoratit të Punës në Kosovë, kundër debitorit NTH “O...”, me NRB:, NRF:, me seli në fshatin, Komuna e Malishevës, duke vendosur lidhur me kërkesën e debitorit për kthim në gjendjen e mëparshme dhe prapësimin e debitorit, të ushtruara me datën 29.05.2019, ndaj Urdhrit Përmbartimor P.nr. 647/17 të datës 27.12.2017 të Përmbartuesit Privat Gjokë Radi, me seli në Gjakovë, jashtë seancës me datën 25.08.2022, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. HEDHET POSHTË si i pa afatshëm propozimi për kthim në gjendjen e mëparshme, i datës 29.05.2019, i paraqitur nga debitori NTH “O...”, me seli në fshatin, Komuna e Malishevës.
- II. HEDHET POSHTË si i pa afatshëm prapësimi i debitorit NTH “O...”, me seli në fshatin, Komuna e Malishevës, i ushtruar kundër urdhrit për lejimin e përmbartimit P.nr. 647/17 të datës 27.12.2017, i lejuar nga Përmbartuesit Privat Gjokë Radi, me seli në Gjakovë.

A r s y e t i m

Kreditori, Qeveria e Republikës së Kosovës - Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale – Trupi Ekzekutiv i Inspektoratit të Punës në Kosovë, ka parashtruar propozim për përmbartim kundër debitorit NTH “O...”, me seli në fshatin, Komuna e Malishevës, për përmbushjen e detyrimit sipas dokumentit përmbartues – Aktvendimi Nr.328/17, i datës 13.04.2017, i formës së prerë me

datë 07.08.2017 dhe i ekzekutueshëm me datë 07.08.2017, me të cilin debitori është obliguar që kreditorit në emër të masës ndëshkimore t'ia paguaj shumën prej 3,700.00€ (tre mijë e shtatëqind euro) në afat prej 8 ditësh, nga dita e pranimit të vendimit në xhirollogarinë Nr.1.... B.P.K., sipas numrit të Aktvendimit.

Përmbaruesi Privat Gjokë Radi, me seli në Gjakovë, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Qeveria e Republikës së Kosovës - Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale – Trupi Ekzekutiv i Inspektoratit të Punës në Kosovë, me datë 27.12.2017, ka lëshuar Urdhrin Përmbarimor P.nr.647/17, me të cilin ka lejuar përmbarimin në bazë të dokumentit përmbarues, Aktvendimit Nr.328/17, të datës 13.04.2017. Kreditori në propozimin për përmbarim të datës 27.12.2017, ka kërkuar që të detyrohet debitori NTH “O...., me seli në fshatin, Komuna e Malishevës, në afatin ligjor, t'ia paguaj kreditorit-Trupit Ekzekutiv të Inspektoratit të Punës në Kosovë, në emër të masës ndëshkimore shumën prej 3,700.00€ (tre mijë e shtatëqind euro), së bashku me kamatën ligjore duke filluar prej 13.04.2017, e deri në pagesën definitive me ndalimin e mjeteve të cilat debitori i ka në llogaritë bankare dhe bartjen e tyre në xhirollogarinë e kreditorit.

Debitori me datë 29.05.2019, ka paraqitur propozim për kthim në gjendjen e mëparshme për shkak të humbjes së afatit për paraqitjen e prapësimit ndaj Urdhrit Përmbarimor P.nr.647/17, të datës 27.12.2017, me arsyetim se debitorit nuk i kujtohet nëse e ka pranuar propozimin apo jo, por për shkak të ngarkesës e ka humbur afatin për paraqitjen e prapësimit.

Së bashku me kërkesën për kthim në gjendje të mëparshme me datë 29.05.2019, debitori ka paraqitur edhe prapësim kundër urdhrit për lejimin e përmbarimit. Në prapësim ka theksuar se urdhri për caktimin e përmbarimit është marrë në shkelje të dispozitave nga neni 71, paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 dhe 1.4 të LPP-së, ngase propozuesi ka paraqitur vetëm vendimin e inspektoratit të punës por nuk ka njoftuar se një vendim i tillë është i plotfuqishëm, pasi që për këtë çështje është paraqitur padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti Administrativ dhe nuk ka përfunduar ende. Andaj dokumenti në bazë të të cilit është caktuar urdhri përmbarimor nuk ka tipare të dokumentit përmbarues dhe si i tillë nuk paraqet titull ekzekutiv. Gjykatës i ka propozuar që urdhri për caktimin e përmbarimit të refuzohet si i pabazuar apo të hedhet poshtë si i pa afatshëm dhe i pa lejuar.

Nga fletëkthesa që gjendet në shkresat e lëndës rezulton se debitori Urdhrin Përmbarimor P.nr.647/17, të datës 27.12.2017, e ka pranuar me datë 30.12.2017, ndërsa kërkesën për kthim në gjendje të mëparshme dhe prapësimin i ka paraqitur me datë 29.05.2019.

Me dispozitën ligjore të nenit 130.3 të LPK-së është paraparë se pas kalimit të gjashtëdhjetë (60) ditëve nga dita e mosveprimit nuk mund të kërkohet kthimi në gjendjen e mëparshme, ndërsa me dispozitën e nenit 509 është paraparë se në procedurën e zgjidhjes së kontesteve tregtare vlen afati prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh për paraqitjen e propozimit për kthimin në gjendjen e mëparshme nga neni 130 paragrafi 3 i LPK-së.

Andaj duke marrë parasysh faktin se debitori urdhrin përmbarimor e ka pranuar me datë 27.12.2017, ndërsa kërkesën për kthim në gjendje të mëparshme e ka paraqitur me datë 29.05.2019, rezulton se e njëjta është paraqitur pas kalimit të afatit 15 ditor, brenda të cilit ka mundur të ushtrohet propozimi dhe nga kjo arsye gjykata vlerësoi se propozim për kthimin në gjendje e mëparshme është i paraqitur jashtë afatit ligjor.

Gjykata po ashtu vlerësoi edhe prapësimin e paraqitur nga ana e debitorit dhe gjeti se prapësimi i debitorit është i pa afatshëm. Sipas vlerësimit të Gjykatës debitori urdhrin për përmbarim P.nr.647/17, të datës 27.12.2017, e ka pranuar me datë 30.12.2017, e cila vërtetohet nga fletë kthesa për dorëzim personal të përmbaruesit privat Gjokë Radi, e cila gjendet në shkresat e lëndës, ndërsa debitori ka ushtruar prapësimin kundër urdhrit për përmbarim me datë 29.05.2019, jashtë afatit ligjor të paraparë me dispozitën e nenit 70 të LPP-së, i cili përcakton se “ *Prapësimi duhet t'i paraqitet Gjykatës brenda shtatë (7) ditëve pas pranimit të vendimit përmbarues ose urdhrit përmbarues*”.

Prandaj bazuar në të lartcekurat, gjykata konform nenit 70 të LPP-së, nenit 133 par. 1 të LPK-së dhe nenit 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE, Dhomat e Shkallës së Parë

Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.419/22, datë 25.08.2022

Gjyqtarja

Verona Dibra

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale në Prishtinë, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.